



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM

Nr. 232, datë 11.05.2023

MBI

**RISHPËRNDARJEN (TRANSFERIMIN) E FONDEVE BUXHETORE NË
PROGRAMIN 03310, PËR VITIN BUXHETOR 2023**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, ligjit nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitin 2023”, Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Udhëzimit Plotësues nr. 2, datë 19.01.2023, “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e rishpërndarjes (transferimit) të fondeve buxhetore, në programin 03310 “Buxheti Gjyqësor”, në shpenzime korrente (600, 601, 602, 606) dhe shpenzime kapitale (231), për vitin buxhetor 2023, sipas pasqyrave nr. 1, dhe nr. 2, bashkëlidhur.
2. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR